# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-451046**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Trump kërcënon BE-në me tarifa pas propozimit për Kanadanë si anëtare e asociuar e bllokut europian: Nëse është akt armiqësor, do reagojmë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/17/trump-kercenon-be-ne-me-tarifa-pas-propozimit-per-kanadane-si-anetare-e-asociuar-e-bllokut-europian-nese-eshte-akt-armiqesor-do-reagojme456464/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 06:43:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 05:23:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 17 shtator 2026, 05:22:00 UTC → 17 shtator 2026, 05:24:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0b49911aa31ebd23ff351836096f48ce27b9917e5cb40fcb38b479478c777629` |
| TEKSTI | `76113430edf535c486d33f2766b4d3ce0341869121d06cffe8fd1c271d026c28` |
| PAMJA | `8cdaf10ad68488cc61fb7c541262371c7dd72efa4628bd94b60eccd9660e2763` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5be4372fbf642b51eef9220302759e04021ef9cbb1d353fa1f7ec4f752553a28` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7552192d4562aa207666eadcaed525346db194fc39c694c2be0ac3ebbafed5c8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5be4372fbf642b51eef9220302759e04021ef9cbb1d353fa1f7ec4f752553a28`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

# Trump kërcënon BE-në me tarifa pas propozimit për Kanadanë si anëtare e asociuar e bllokut europian: Nëse është akt armiqësor, do reagojmë

17/09/2026 07:23



**Presidenti amerikan Donald Trump ka kërcënuar Bashkimin Europian me vendosjen e tarifave të rënda dhe madje me kufizime në tregti, pasi Brukseli propozoi që Kanadaja të bëhet anëtarja e parë "e asociuar" e BE-së.**

Gjatë një prononcimi për mediat, Trump e cilësoi si "qesharake" idenë e një afrimi të tillë mes Kanadasë dhe Bashkimit Europian dhe paralajmëroi se reagimi i Uashingtonit do të varet nga qëllimet që ai i atribuon këtij propozimi.

"Nëse është një akt armiqësor, do të vendos tarifa shumë të rënda", deklaroi Trump.

Ai shtoi se nëse SHBA-ja vlerëson se Europa ka "qëllime të këqija", Uashingtoni mund të vendosë tarifa shumë të larta ndaj vendeve europiane.

"Nëse kanë qëllime të mira, shumë mirë. Nëse kanë qëllime të këqija, do të vendosim tarifa shumë të rënda ndaj Europës", tha presidenti amerikan. Trump la gjithashtu të hapur mundësinë e ndërprerjes së tregtisë me Europën në disa sektorë.

Presidenti amerikan kritikoi edhe Kanadanë, duke e cilësuar si një "partner të tmerrshëm tregtar" të Shteteve të Bashkuara.

**Propozimi i von der Leyen**

Deklaratat e Trump erdhën një ditë pasi presidentja e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen, propozoi që Kanadaja të bëhet anëtarja e parë "e asociuar" e Bashkimit Europian.

Propozimi u bë gjatë fjalimit të saj vjetor për gjendjen e Bashkimit Europian në Parlamentin Europian, në Strasburg, ku ishte i pranishëm edhe kryeministri kanadez Mark Carney.

Von der Leyen deklaroi se dëshiron të hapë rrugën për një formë të re dhe shumë më të afërt bashkëpunimi me Kanadanë, që do të përfshinte tregtinë, mbrojtjen, teknologjinë, energjinë, mineralet kritike dhe çështjet që lidhen me Arktikun.

"Do të doja të punoja me ju për t'i hapur derën Kanadasë si anëtarja e parë e asociuar e BE-së", tha von der Leyen, duke iu drejtuar kryeministrit Carney.

Ky status nuk ekziston aktualisht në traktatet e Bashkimit Europian dhe detajet ligjore e institucionale të mënyrës se si mund të zbatohet ende nuk janë përcaktuar. Për këtë arsye, propozimi përfaqëson një formë të re partneriteti dhe jo anëtarësim të plotë në BE.

Von der Leyen tha se Brukseli dhe Ottawa synojnë të ndërtojnë një "aleancë për të ardhmen", duke u mbështetur edhe te marrëveshja ekzistuese e tregtisë së lirë mes BE-


## Kryesore



Sot seancë plenare/ Pesë interpelanca në rend dite, Kuvendi vendos edhe për pagat e gjyqtarëve e prokurorëve
07:37

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve
19:35

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!
19:10

"E respektojmë aktgjykimin e Dhomave të Specializuara"/ Reagon SHBA pas vendimit të Hagës: Të shmanget retorika nxitëse
15:47

"Topin e kam unë" së shpejti në Top Channel! Apliko tani në top-channel.tv
16:40

## Më të lexuarat

Dënimi me 81 vite burg i ish-liderëve të UÇK, Vuçiç del në konferencë dhe ankohet: Nuk janë dënuar për krime kundër njerëzimit

Nuk kënaqet me 81 vite burg për ish-krerët e UÇK, Prokurorja e Specializuar e Hagës: Do kërkojmë në Apel dënim edhe për krimet kundër njerëzimit

Gjykata e Hagës dënon me 81 vite burg për krime lufte liderët e UÇK-së. Prishtina "ngrihet në këmbë" për Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin, protesta para institucioneve

"A ka rrezik të vdesë në burg?"/ Milaim Zeka shpërthen në lot, tregon komentin e vajzës për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan me 81 vite burg total, reagon Rama: Marre!

Ekskluzive/ "Jam i rënduar psikologjikisht, Thaçin tani do e kem më shumë mik", Majko i përlotur: Shqipëria e Kosova të shtrëngojnë dhëmbët dhe...

"Të respektohen vendimet e Hagës"/ Dënimi i liderëve të UÇK-së, Grenell i përgjigjet deklaratës së Marta Kos: Këto gjykata radikale duhet të mbyllen

Vuçiçit nuk i del inati/ 'Studion' reagimet e zyrtarëve të lartë të rajonit pas vendimit në

së dhe Kanadasë, CETA. Bashkëpunimi i propozuar do të shtrihej përtej tregtisë, në fusha si mbrojtja, inteligjenca artificiale, energjia dhe lëndët e para kritike.

Kryeministri kanadez Mark Carney ka deklaruar më herët se Ottawa dëshiron të ndërtojë një "aleancë unike" me Bashkimin Europian, pa kërkuar anëtarësim të plotë në Union.

**Top Channel**

Hage, ndalet te Begaj e Rama, kercenon Malin e Zi

"Apeli nuk do të sjellë ndryshime"/ Vendimi për liderët e UÇK-së, avokatja përlotet në 'Top Story': Edhe nëse 'Specialja' zhbëhet, nuk ka fuqi mbi dënimin e dhënë

Dënimi me burg për 4 liderët e UÇK-së, reagon komisionerja Marta Kos: Vendimet e Hagës duhet të respektohen

## Bota »



"Nuk na ka paguar prej 6 muajsh", avokatët e Diddy-t kërkojnë tërheqjen nga padia për shpifje

16/09 22:41



Publikohen fotot e dëmeve nga sulmet iraniane në bazat amerikane, avionë të dëmtuar dhe infrastrukturë e shkatërruar në Lindjen e Mesme

16/09 22:31



Libri i Charles Spencer zbulon përplasjen me mbretin Charles pas vdekjes së Lady D: Do ta harrojmë shpejt Dianën

16/09 21:27



Alarm në Frankfurt, dy të vdekur nga malaria, dyshohet se mushkonjat e infektuara janë transportuar përmes fluturimeve nga Gjermania

16/09 18:30



Tragjedi në Alpet Zvicerane, tre të vdekur pas rrëzimit të një aeroplani të vogël

16/09 17:41



Alarm në Britani/ 3-vjeçari zhduket nga këndi i lojërave, policia dhe mbi 1,000 vullnetarë në kërkim të Noah

16/09 16:47

## Kryesore »



Vendimi i Hagës për liderët e UÇK-së, Karamuço në 'Top Story': "Hambar" me spiunë që dëshmuan, një lojë e Serbisë

17/09 08:17



"Liria ka emër", Dua Lipa reagon pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së: Askush nuk ka të drejtë ta njollosë luftën për liri

17/09 08:02



Sot seancë plenare/ Pesë interpelanca në rend dite, Kuvendi vendos edhe për pagat e gjyqtarëve e prokurorëve

17/09 07:37



Haga dënoi me 81 vite burg liderët e UÇK-së, deputeti i PDK-së në "Top Story": U përmbys çdo ide e drejtësisë, Kosova viktimë e një rendi të ri

17/09 07:20



Kushte të qëndrueshme atmosferike, parashikimi i motit për këtë të enjte

17/09 07:10



Rikthim i hidhur për Milanin, kuqezinjtë e nisin aventurën europiane me humbje ndaj Benficës

16/09 22:57

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ Dënimet në Hagë, Vuçiçit nuk i del inati me shqiptarët, kërcënon e shpërthen ndaj Ramës

Top Channel/ BE ndalon rrjetet sociale nën 13 vjeç: Mbrojmë fëmijët

Top Channel/ Durrës, plagoset avokati, një 61 vjeçar e qëlloi me armë zjarri

Top Channel/ Avokatët e Thacit & Co: Do ta apelojmë, vendim i paracaktuar

Top Channel/ Lot dhe protestë në Prishtinë e Hagë, Turma marshoi drejt EULEX-it

Top Channel/ Vuçiç në “sulm”: Shqipëria fyeu gjykatën, preket integrimi



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.